



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2479/Prot.
3

Tiranë, më 28.12.2020

VENDIM QARKULLUES

Nr. 108, datë 29.12.2020

“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit Qarkullues nr. 28.04.2020 "Mbi zhvillimin e proceseve akademike në situatën e krijuar nga infeksioni Covid-19 në UMT" të Senatit Akademik, pika II dhe IV, në propozimet e njësive kryesore përkatësisht të Fakultetit të Mjekësisë me shkresë nr. 2219/6 prot., datë 24.12.2020 dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare me shkresë nr. 473/2 prot., datë 23.11.2020, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2020-2021, janë 285 kuota.
2. Kuotat e pranimi për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Aplikojnë, për programe studimi specializuese, afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
4. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Tarifa e konkurrit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
6. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
7. Shpërndarja e kuotave të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, sipas çdo programi studimi, bëhet me vendim të Senatit Akademik. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas kësaj pike të këtij vendimi, lidhin kontrata, përkatësisht me ministrinë përkatëse ku përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.
8. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në pikën 7 të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, një shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse, pa efekte buxhetore shtesë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendrës së Shërbimeve Arsimore, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme për bashkëpunimin dhe vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në rregulloren e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fuqi.
11. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të UMT-së, për miratimin e tarifave të propozuara në pikën 5 të këtij vendimi.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA



Tabela nr. 1: Kuotat e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve “Specializim Afatgjatë” në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2020-2021

Nr.	NJËSIA KRYESORE	PROGRAMI I STUDIMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021
1	F. MJEKËSISË	ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE	5
2	F. MJEKËSISË	ANATOMI PATOLOGJIKE	5
3	F. MJEKËSISË	ANESTEZI-REANIMACION	20
4	F. MJEKËSISË	DIAGNOZË ME IMAZHE	5
5	F. MJEKËSISË	ENDOKRINOLOGJI	5
6	F. MJEKËSISË	GASTROHEPATOLOGJI	5
7	F. MJEKËSISË	HEMATOLOGJI	5
8	F. MJEKËSISË	KARDIOLOGJI	10
9	F. MJEKËSISË	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	10
10	F. MJEKËSISË	LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK	5
11	F. MJEKËSISË	MIKROBIOLOGJI	5
12	F. MJEKËSISË	MJEKËSI E URGJENCËS	15
13	F. MJEKËSISË	MJEKËSI FAMILJE	30
14	F. MJEKËSISË	MJEKËSI INTERNE	10
15	F. MJEKËSISË	MJEKËSI TRANSFUZIVE	5
16	F. MJEKËSISË	NEFROLOGJI	5
17	F. MJEKËSISË	NEUROKIRURGJI	5
18	F. MJEKËSISË	NEUROLOGJI	5
19	F. MJEKËSISË	OBSTETRIKE-GJINEKOLOGJI	10
20	F. MJEKËSISË	ONKOLOGJI	10
21	F. MJEKËSISË	ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI	5
22	F. MJEKËSISË	OTORINOLARINGOLOGJI	5
23	F. MJEKËSISË	PEDIATRI	20
24	F. MJEKËSISË	PNEUMOLOGJI	10
25	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI	10
26	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI E FEMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE	5
27	F. MJEKËSISË	REUMATOLOGJI	10
28	F. MJEKËSISË	SËMUNDJE INFEKTIVE	20
29	F. MJEKËSISË	SHËNDET PUBLIK	10
30	F. I MJEKËSISË DENTARE	KIRURGJI ORO-MAKSILLI FACIALE	10

5 kuota për transferim studimesh ne programet e specializimeve afatgjata në Fakultetin e Mjekësisë, UMT